

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Smart Track Solutions” sh.p.k.**

Sot, më datë 05/04/2024 në Tiranë, Shqipëri u vendos për sa më posht vijon,

Znj.Kristjana Shkurti, atësia Flamur, amësia Naxhire , e datëlindjes 05/02/1997, lindur në Berat dhe banuese në Berat, në adresën Blloku i Pallateve, Nd.12, H3, Ap.7, Velabisht, Bilçë, Berat, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Id me nr.personal J75205001T, me nr.passaporte BR3032170, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,vendosi

të nënshkruaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm,të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet sipas legjisacionit shqiptarë në fuqi dhe sipas Statutit të saj.

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është “**Smart Track Solutions**” sh.p.k, këtu më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**.
Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjisacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Besim Alla”, Pallati Daks 2013, Shkalla 4, Ap 1-21, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:
Tregëtim, instalim , mirëmbajtje e sistemeve të sigurisë, import dhe eksport pajisjesh sipas objektit të veprimtarisë së shoqërisë, sipas legjisacionit në fuqi.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5
Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë;
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1(një) kuotë, kapitali i cili paguhet nga ortaku;

Znj.Kristjana Shkurti, atësia Flamur, amësia Naxhire, e datëlindjes 05/02/1997, lindur në Berat dhe banuese në adresën Blloku i Pallateve, Nd.12, H3, Ap.7, Velabisht, Bilçë, Berat, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Id me nr.personal J75205001T, me nr.passaport BR3032170, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruese i 1 (një) kuote të kapitalit ,me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë, që përfaqëson 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

- 6.1 Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Asambleja e Përgjithshme

- 6.2 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të Ortakun, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7
Administratori

- 7.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

Znj.Kristjana Shkurti, atësia Flamur, amësia Naxhire, e datëlindjes 05/02/1997, lindur në Berat dhe banuese në adresën Blloku i Pallateve, Nd.12, H3, Ap.7, Velabisht, Bilçë, Berat,

identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Id me nr.personal J75205001T, me nr.passaport BR3032170, nr. Cel 0677445555 dhe e-mail kristjana.shkurti@gmail.com, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- 7.2 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm dhe nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.3 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8
Viti Financiar

- 8.1 Viti finansiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2023.

Neni 9
Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.
- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumenteve si më lartë, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërisht detyruar.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua lirisht nga pala si më sipër duke shprehur vullnetin e lirë dhe të plotë.

ORTAKU I SHOQËRISË “SMART TRACK SOLUTIONS” SH.P.K

Kristjana Shkurti

Kristjana Shkurti
[Handwritten signature]